

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

**KONTRIBUTI I SHËRBIMEVE GJATË LOJËS NË REZULTATIN PËRFUNDIMTAR
NË VOLEJBOLL NË FINALET E KUPËS TË KOSOVËS 2018 DHE 2019**

MENTORI:
Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi

KANDIDATJA:
Pranverë Sylejmani-Ahmeti

Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. HULUMTIMET E GJERTANISHME	9
3. QËLLIMI I PUNIMIT	15
4. HIPOTEZAT THEMELORE	16
5. METODOLOGJIA E PUNËS	17
5.1 MOSTRA E ENTITETIT	17
5.2 NDRYSHORET E APLIKUARA	17
5.2 TEKNIKA E EKZEKUTIMIT TË SHËRBIMEVE.....	18
5.2.1 Shërbimi - Teknika e ekzekutimit.....	18
5.2.2 Shërbimi tenis	20
5.2.3 Shërbimi valëvitës.....	22
5.2.4 Shërbimi me kërcim.....	24
5.3 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	29
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI.....	30
6.1 ANALIZA E REZULTATEVE TEKNIKE TE LOJTARET E EKIPES FITUESE KV “SKENDERAJ” DHE KV „M-TECHONOLOGIE PRISHTINA VOLEY“	30
6.2 ANALIZA E REZULTATEVE TEKNIKE TE LOJTARET E EKIPES FITUESE KV “KASTRIOTI” DHE KV „DRITA“	41
6.3 DALLIMI NË MES SHËRBIMEVE BRENDA SETEVE DHE NË MES SETEVE TE EKIPET FINALISTE NË KUPEN E KOSOVËS 2018 DHE 2019.....	54
6.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	56
7. PËRFUNDIMI	57
8. LITERATURA	59

1. HYRJJE

Volejboli, si një lojë sportive në rrugën e saj zhvillimore, nga nevoja për ta bërë seancën e ushtrimeve më interesante deri tek afirmimi i kësaj loje si lojë më interesante dhe masive sportive, ka kaluar në disa faza. Një nga të parët ishte "gjallëria", kur volejbollistët do të mblidheshin një herë në javë për lojë. Me kalimin e kohës, ajo veçohet si një degë e veçantë sportive, e cila rezulton në kalimin në fazën tjetër të zhvillimit, d.m.th. ka nevojë për grumbullim më të shpeshtë të volejbollistëve. Trajnimi sistematik gjithashtu fillon të përmirësojë lojën e ekipit. Më pas, ekzistonte nevoja për të vlerësuar këtë ushtrim sistematik përmes garave. Kjo nevojë paraqiste hyrjen në një fazë të re e cila lidhet me formimin e organizatës më të gjerë të volejbollit. Garat po rriten në numër dhe po zgjerohen në zona më të mëdha. Modernizimi i trajnimit të volejbollit në Evropë vjen nga Lindja, veçanërisht nga Japonia. Shenja më domethënëse në këtë skenë ishte "Tajfuni Lindor" (Nichibo). Ata ishin të parët që futën kuantitetin në teknologjinë e trajnimit si një bazë për sukses. Volejboli bashkëkohor, si sporti në përgjithësi, është gjithnjë e më i lidhur me shkencën. (Tomic me bp. 2012).

Në një lojë sportive ku lejohet një kontakt me topin (duke mos llogaritur bllokun), është shumë e vështirë të mos bëhen gabime. Duke stërvitur dhe duke ekspozuar nivelin më të lartë të teknikës së duhur, numri i gabimeve është zvogëluar. Për kënaqësinë e përgjithshme, njohuritë shkencore gjithnjë e më shumë përfaqësohen në teknologjinë e stërvitjes, e cila po përcillet nga një numër në rritje i ekipeve, i cili nga ana tjetër kontribuon në ndryshime të shumta në lojë, kështu që pyetja është se cili është segmenti në të cilin mund të përmirësojnë lojën e tyre në mënyrë që të mbajnë ekipin përpara nga ekipi tjetër dhe të arrihet fitorja. Sigurisht që është kjo një segment i zvogëlimit të gabimeve të vet lojtarit dhe në të njëjtën kohë detyron kundërshtarin të bëjë më shumë gabime. Sidoqoftë, numri i gabimeve si një tregues numerik nuk jep informacion mjaftueshëm të qartë sa i përket raportit të gabimit në përpjekjen për të shënuar pikë (Osmankač, 2008).

Rëndësia e përvetësimit të teknikës në nivelin më të lartë të mundshëm pasqyrohet pikërisht në ndeshjet e pasigurta. Atëherë lojtarët reagojnë në mënyrë të pavetëdijshme dhe shpesh bëjnë gabime të pashpjegueshme për të cilat gabime disa trajner mendojnë se nuk ndikonë në rezultatin përfundimtar të lojës. Nëse futemi në një analizë më të hollësishme, mund të konkludohet se deri te teknika e dobët e ekzekutimit dhe deri ta paraqitja e gabimet ka ardhur për shkak të ushtrimit të tepruar me ngarkesa të rënda. Duke pasur parasysht që një numër i madh

i gabimeve, përveç mungesës së rezultatit, çon në një rënie psikologjike të lojtarit, gjë që gjithashtu shkakton pasiguri në lojë, mund të merret me mend se cilat do të ishin pasojat e gabimit për rezultatin përfundimtar. Prandaj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur punoni me ngarkesa në peshë dhe të bëhet një konceptim më mirë në mikro cikël gjatë stërvitjeve në palestër (Tomić i sar. 2012).

Sistemi ofensivë i lojës në sulm është një sistem i ri i paparashikueshëm. Çdo skuadër apo reprezentacion i volejbollit, duhet të gjejë modelin e vet të lojës që i përshtatet më së miri mentalitetit të saj. Në këtë mënyrë, mund të arrij edhe mbi mundësit e veta, me sakrificat të mëdha dhe qasje shkencore gjatë monitorimit dhe përcjelljes së sistemit të këtyre elementeve:

1. Numri i hapave gjatë lojës sillet rreth 344, dhe përfundon me ritmin këmba e majtë e djathtë që është i rëndësishëm në përfundimin e ekzekutimi të ndonjë elementi.

2. Të jenë përherë katër sulmues: tre përpara dhe një prapa (vija e 2).

3. Sulmuesi i ritmit (tempit) (i paparashikueshëm) dy, lëviz në drejtim të qendrës, dhe realizon sulmin në pjesën e jashtme të fushës. Sulmi është i bazuar në përqendrimin e lojtarit të parë apo tempi 1 (bllokues i mesme) që shkon në pjesën e jashtme.

4. Gjuajtësit nga vija e dytë kanë kohë për të monitoruar organizimin e bllokut të skuadrës kundërshtarë dhe mund të ta përshtatin vrullin dhe sulmin në bllokuesin më të dobët.

5. Tekniku duhet të përpiqet të ngrit më shumë topa në vijën e dytë.

Ky sistem kërkon lëvizshmërinë e vazhdueshme të lojtarëve në sulm. Lëvizja e lojtarëve në vazhdimësi çon në rrethanat rënduese (vështirësuese) për bllokun e skuadrës kundërshtarët. Ashtu si në sportet tjera ekipore, sukcesi në lojën e volejbollit varet nga një numër i madh i faktorëve komplekse dhe të ndërlydhura. Këta faktorë janë: (1) përgatitja teknike, (2) përgatitja fizike, (3) përgatitja taktike, (4) aftësia për të marrë vendime në lojë, (5) stabiliteti psikologjik, (6) pritja e momentit të dëshiruar, (7) karakteri dhe aftësitë e komunikimit, dhe (8) aftësitë e udhëheqjes.

Përveç këtyre faktorëve, ekipi i suksesshëm kërkon edhe organizimin e mirë në kuptimin që çdo lojtare e ka rolin e vet dhe që në mënyrë specifike kontribuon në arritjen e këtij sukcesi. Nga aspekti i strukturës së lojës në volejball ekzistojnë dy faza themelore: faza e sulmit dhe faza e mbrojtjes. Secilën nga këto faza e karakterizojnë probleme të veçanta taktike dhe shkathtësi specifike teknike me të cilat mund të zgjidhen këto probleme. Megjithatë, shpesh është e harruar shpesh edhe faza e tretë: faza e tranzicionit, e cila për dallim nga lojërat tjera

sportive në volejboll është shumë e shkurtër dhe e rafinuar, ashtu që të shprehemi, është shumë e rëndësishme në lojë. Ekipet elitë i karakterizon efikasiteti i lartë dhe tranzicioni i shpejtë në lojë, që mundëson zbatimin efikas të fazës së sulmit dhe të mbrojtjes, dhe shikuesve u duket si një "valle e koordinuar" në mes të anëtarëve të ekipit.

Perceptim i mirë dhe serioziteti gjatë lojës për hapësirën dhe terrenin është i nevojshme që lojtari apo ekipi me sukses ta s'postoj kundërshtarin në mënyrë që të bëjë vend për sulmin. Nga ana tjetër, lojtarët duhet të mbrojnë hapësirën në terren, duke u vendosur në pozitë më të mirë për ta kthyer topin. Lojtaret duhet të marrë në konsideratë avantazhet dhe disavantazhet, si dhe të kundërshtarit, para përzgjedhjes dhe zbatimit të aftësive teknike. Vendimi i një lojtar duhet të marrë parasysh pozicionet e lojtarëve të tyre dhe të kundërshtarit.

Siç u vu në dukje, volejboli është sport specifik apo një sport të veçantë në atë që është sport i vetëm ekipor në kategorinë e sportit të rrjetit / mur. Pasi që ekipit kundërshtar janë të ndara me rrjetë, nuk ekziston duel loja (me përjashtim të shtyrjes gjatë bllokut). Përveç këtyre karakteristikave, për shkak të kontaktit shumë të shkurtër me topin, volejbollin e karakterizon lidhja shumë e madhe përsëritëse të elementeve teknike, respektivisht faza e lojës (pranimi-ngritja-gjuajtja), ashtu që elementi i ekzekutuar dobët shkakton elementet që pasojnë. Nga aspekti i strukturës së lojës lë lojërat sportive ekzistojnë dy faza themelore: faza e sulmit dhe faza e mbrojtjes.

Secilën nga këto faza e karakterizojnë probleme të veçanta taktike dhe shkathtësi specifike teknike me të cilat mund të zgjidhen këto probleme. Megjithatë, shpesh është e harruar shpesh edhe faza e tretë: faza e tranzicionit, e cila për dallim nga lojërat tjera sportive në volejboll është shumë e shkurtër dhe e rafinuar, ashtu që të shprehemi, është shumë e rëndësishme në lojë. Ekipet elitë i karakterizon efikasiteti i lartë dhe tranzicioni i shpejtë në lojë, që mundëson zbatimin efikas të fazës së sulmit dhe të mbrojtjes, dhe shikuesve u duket si një "valle e koordinuar" në mes të anëtarëve të ekipit.

Është me rëndësi të veçantë që gjatë lojës të përcjellim dhe analizojmë disa parametra gjatë lojës që janë të rëndësishëm si informacione mbi kahet e zhvillimit të lojës dhe angazhimin e lojtarëve gjatë lojës. Këtë mund ta bëjmë me anë të kamerave të vendosura në pjesë të ndryshme të fushës duke i analizuar me anë të programeve të ndryshme. Me rëndësi është që mund të përcjellim aktivitetet gjatë lojës.

- **Analiza e aktiviteteve garuese** respektivisht e lojës është analiza gjatë lojës. Përveç analizës së përmendur strukturore (i cili përcakton fazat dhe elemente teknike dhe modele lëvizëse të lojës, që paraqiten gjatë lojës). Ka edhe disa lloje të analizave që janë analiza më e rëndësishme analiza e rezultateve apo simboleve, analiza e lëvizore - kohore dhe analiza funksionale.

- **Analiza e rezultateve** merret me analizimin e elementeve teknike dhe taktike, numrin e tyre, variacionet dhe efikasitetin gjatë lojës. Specialist për analizën e rezultateve, simboleve apo e të dhënave është statisticienti (personi që mbanë statistikat) i cili është zakonisht pjesë e stafit profesional. Volejbolli Modern kërkon kohë reale të analizave të rezultateve gjatë lojës, i cili siguron trajnerit informacione në formën e tendencës (drejtimin e sulmeve etj), karakteristikat e mira dhe të dobëta të skuadrës së vet, por edhe të kundërshtarit, mbi bazën e të cilave trajneri mund të sigurojë disa nga udhëzimet taktike për lojtarët dhe të përcaktojë një strategji të re ose plan të ri të lojës.

- **Analiza lëvizore-kohore**, është një analizë e ngjashme me analizën e rezultateve apo simboleve sipas asaj disa lëvizje si të dhëna analizohen (në këtë rastin konkret këtë mund ta bëjë kompjuteri përmes monitorimit nga largësia të lojtarëve), por këtu janë përfshirë edhe intensiteti i lëvizjes dhe kohëzgjatja e tij (komponenti kohore). Qëllimi i analizës kohore lëvizore është përcaktimi i shpeshtësisë së ndodhjes (paraqitjes) së lëvizjeve të caktuara dhe intensitet, kombinimin e tyre, kohëzgjatjen e një lëvizje të caktuar, si dhe përcaktimi i specifikës të punës-çlodhjes me qëllim të përcaktimit dhe përkufizimi më të mirë e trajnimit sportiv-specifik, respektivisht kondicionit, si dhe monitorimin e angazhimit të lojtarit.

- **Analiza funksionale** fokusohet në monitorimin e parametrave fiziologjike gjatë lojës, të tilla si te rrahurat e zemrës, konsumimi i oksigjenit, niveli i laktatit në gjak dhe muskuj, etj., me qëllim të sigurimit të informacioneve mbi strukturën dhe dominimin e proceseve të energjisë gjatë lojës.

Në volejbolli teknikat speciale të lojës luajnë rol të rëndësishëm në arritjen e rezultateve të larta të ekipit. Çdo ekip duhet gjetur modelin e tij të lojës që i përshtatet mentalitetit të saj. Në këtë mënyrë ajo mund të shkojë përtej aftësive të veta me sakrificat të mëdha, qasje shkencore dhe sistematike duke përcjellë inovacione në botën volejbolli. Janë të njohura tri teknika të veçanta për suksesin e lojës së volejbolli:

- Te - Ta Blokut

- Te - Ta Mbrojtjes
- Te - Ta Sulmit

Loja e volejbollit ndahet në fazën e sulmit, mbrojtjes dhe të tranzicionit. Nga emërtimi nënkuptohet, se faza e **tranzicionit** është fazë ndërmjet sulmit dhe mbrojtjes, apo të mbrojtjes dhe sulmit. Në volejboll faza e tranzicionit ndodh çdo herë kur topi kalon rrjetën. Karakteristika e fazës së tranzicionit është jo vetëm tranzicioni në mes kërkesave taktike, por edhe kalimin nga një gjendje psikologjike në tjetrën gjendje psikologjike, shembull kalimi nga gjendja psikologjike e agresivitetit gjatë sulmit në një gjendje të "luajtjes të sigurt" për mbrojtje. Rëndësisë së tranzicionit në volejboll i kontribuon më tej përgatitja psikologjike e lojtarëve, komunikimi, dhe saktësisht strategjia dhe plani i definuar i lojës. Loja e volejbollit pas ndarjes në fazën e sulmit, mbrojtjes dhe të tranzicionit mund të ndahet në elementet e mëposhtme:

Për çdo element i lojës së volejbollit si karakteristikë janë problemet taktike dhe shkathtësitë teknike. Ka një numër të elementeve teknike që përdoren në element të veçantë të lojës sidomos në fazën e mbrojtjes, dhe në zbatimin e tyre të suksesshëm të këtyre aftësive motorike ndikojnë shumë faktorë. Një lojtar i volejbollit përmes një lojë "të vështirë" prej 5 seteve ekzekuton rreth: 250-300 aksione. Nga këto aksione 50-60% janë kërcime, 27-33% janë lëvizje të shpejta dhe ndryshime të drejtimit në një hapësirë të vogël, dhe 12-17% ramje me rrëshqitje për dysheme. Rregullat e reja të lojës, respektivisht futjen (Rally Sistemit Point) çdo aksion pikë, ka sjellë informacion të reja dhe shumë të rëndësishme të tilla si:

- Kohëzgjatja rreth 90 min (para rreth 120min)
- Kohëzgjatja e fazës aktive (lojë) prej 3-10 sek; kohëzgjatja e fazës pasive 13-16 sek (kohëzgjatja e fazës aktive e femrave më e gjatë se e meshkujve)
- 53.02% të aksioneve zgjasin më pak se 5 sekonda, 15.43% të aksioneve zgjasin 5-7 sekonda (nga rregullat e vjetra deri në vitin 1999 këto aksione ishin dominuese – dhe përbënin rreth 42% të aksioneve.); 11.36% e aksioneve zgjasin nga 7-10sec
- Në setin e pestë në mënyrë të konsiderueshme rritet, faza aktive mbi 6 sek. Analizë sipas pozicioneve (sistemi 5-1) tregon në ngarkesa të ndryshme në mes të lojtarëve:
- Pasuesi 130 kërcime (kryesisht me qëllim të ngritjes, nga të cilat shumica me intensitet submaksimal)
- Bllokuesi i mesëm rreth 100 sulme
- Kryesulmuesi rreth 90 gjuajtje

- **Pranuesi** rreth 70 kërcime

Duhet të theksojmë se struktura dhe karakteristikat e volejbollit moderne ndryshojnë te meshkujt dhe femrat. Për këtë ne mund të supozojmë nga rezultatet e marra në studimin e Gjurković , T. (2007.) në mostrën e meshkujve e të njëjtit grup moshave . Autori në hulumtimin ka fituar rezultate në të cilat funksionet diskriminonte dukshëm dallojnë dy grupet e ekipeve në një nivel të rëndësisë së 0.01 ($p < 0.01$) në rotacionet pesë dhe tre. Këto janë rotacione kur pasuesi gjendet në situatë më të papërshtatshëm ku gjatë pranimit të shërbimit duhet të vrapoj nga ana e majtë e rrjetës dhe ka rrugë më të gjatë të vrapimit. Është e mundur që në volejbollin për femra, këto dallime ndër të tjera nuk janë statistikiisht të rëndësishme për shkak të numrit të vogël të shërbimeve të fuqishme me kërcim ke kadetët . Shërbime të tilla të fuqishme dhe të shpejtë, ndër të tjera , shkurtojnë kohën e përgatitjes të pasuesi në të cilin rast duhet shpejt të vrapoj, shpejt të vendoset në pranimin e topit dhe me saktësi të organizojnë sulmin e tyre . Në këtë hulumtim të lartpërmendur me kadet është analizuar veçmas rotacioni kur pasuesi është në zonën e përparme dhe zonën e pasme. Me anë të Analizës diskriminative janë fituar dallime të mëdha në parametrat e situacional në favor të ekipeve më të suksesshme dhe të pasuara ma mirë në ranglistë. Ne supozojmë se shërbimi me kërcim dhe gjuajtja e sulmuesit diagonal nga zonën e pasme te kadetët njëra nga arsyet për dallimet në rezultatet e hulumtimit të mëparshëm për kadetë. Shikuar në aspektin empirik është e qartë se shumica e risive në teknologji dhe taktikat e lojës fillon te meshkujt.

2. HULUMTIMET E GJERTANISHME

Hulumtimet e gjertanishme, sa i përket ndikimit të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në arritjen e suksesit në lojën e volejbollit janë të shumta, por, janë të pakta hulumtimet të colat kanë hulumtuar ndikimin e shërbimeve në suksesin përfundimtar në lojën e volejbollit. Do ti përmendim disa nga këta autorë.

Vuković (1996) në hulumtimin e tij ka vërtetuar ekzistencën e ndryshimeve statistikisht domethënëse në karakteristikat e ekzaminuara, si në hapësirën manifestuese ashtu edhe në hapësirën e latente. Dallimet e identifikuar favorizojnë shkallët më të larta të garave, duke parë nga këndvështrimi i suksesit në lojën e volejbollit.

Antoniadis (1997) ka hulumtuar suksesin në zbatimin e elementeve teknike dhe taktike në turneun përfundimtar të garës EP 1995 në Athinë. Ai vëzhgoi dhe analizoi variablat: gjuajtjet, bllokun, shërbimet, mbrojtje e fushës, ngritjen e topit dhe pranimin e shërbimit. Rezultatet e fituara treguan se niveli i suksesit në zbatimin e elementeve të analizuar është kryesisht në përputhje me renditjen e grupeve, domethënë plasmanin e ekipeve. Shkalla më e lartë e varësisë vërehet në elementet e lojës të cilat në thelb janë përgatitja dhe realizimi i vetë fazës së sulmit, siç është pranimi i shërbimit, ngritja dhe gjuajtja. Variablat që përfaqësojnë akcionin e zakonshëm në fazën e mbrojtjes shfaqën disa mospërputhje të vogla, të vogla ose të mëdha, si ndërmjet grupeve ashtu edhe brenda secilit grup.

Gjurković, T. (2007) i cili ka analizuar lojën gjatë një rrotullimi dhe ka nxjerr shkaktarët e humbjes së pikës. Ndër shkaktarët e humbjes së pikës ka nxjerrë pranimin e dobët të shërbimit nga ana e lojtares. Gjithashtu me metoda statistikore autorët MVZ, HJ, Schuttz, RW 1992, Janis, L., Panagiotis K. 2005 kanë diagnostifikuar shkaktarët e humbjes së pikëve duke i renditur në rend të parë shërbimin e papërshtatshëm, pranimin e dobët të shërbimit si dhe ngritjen e topit në mënyrë jo adekuate. Trajneri duhet të dijë, pra, modelet statistikore të suksesit për skuadrën, fazat individuale të lojës, pozicionet lojtarëve, setet veç e veç, dhe lojën. Pikërisht për shkak të nevojës për ta kuptuar lojën e dobët në të gjashtë rotacionet në të gjitha setet e luajtura duhet të diagnostikuar arsyen.

Në këtë drejtim (Zett, E., Tsigilis, N., Moustakidis, A., Komninakidou, A. 2006) me anë të videoprojektorëve kanë arritur të identifikojnë gabimet e bëra gjatë lojës nga ana e ekipeve të ndryshme në të gjitha fazat e lojës: gjatë shërbimeve, gjatë gjuajtjeve, gjatë bllokut, gjatë

pranimi me “çekan”, gjatë pasimit me gishtërinj. Autorët kanë arritur në përfundim se gjatë lojës aplikimi i statistikave të nxjerrura nga videoprojektorët dhe programet e caktuara statistikore ndihmojnë trajnerët që ti përmirësojnë gabimet e bëra nga ana e skuadrës së vet.

Osmancak, N. (2008). Në hulumtimin e tij është me analizën e rregullave të caktuara të lojës së volejbollit, dhe si shembull u mor ekipi rus i volejbollit, i cili luajti 28 ndeshje në vitin 2006 në dy gara (Liga Botërore dhe Kupa Botërore). Studimi kishte gjithashtu dimensionin e një eksperimenti ex post fakto, pasi kishte të dhëna të mbledhura dhe të formuara në një bazë të dhënash specifike të pavarur nga autori. Është përcjell një ekipi kombëtar, i cili luajti ndeshje në nivele të ndryshme cilësore me kundërshtarë të ndryshëm. Të dhënat u grumbulluan duke vëzhguar regjistrin e ngjarjeve me një program të njohur dhe të përgatitur ("DATA-VOLLEY"). Bazuar në rezultatet e marra nga analiza e elementeve teknike dhe taktike të volejbollit (shërbimi, pranimi i shërbimit, mbrojtja e fushës, blloku, sulmi, pritja-sulmi, mbrojtja-sulmi), autori konkludon se statistikave në volejbollin modern janë shumë të rëndësishme, por edhe një mjet i rrezikshëm. Ajo i jep një pamje më të qartë shumë dukurive, gjen arsyet për to, por nëse nuk përdoret me kujdes mund të çojë në drejtim të gabuar. Hartimi i taktikës dhe orientimi strategjik i një ekipi me indikatorë statistikore të keqinterpretuar mund të çojnë në gabime të pariparueshme dhe dëme të pariparueshme në arritjen e rezultateve.

Në hulumtimin e tyre, Afonso me bp. (2010) kanë analizuar rëndësinë e performancës në mënyrë që të kuptojnë faktorët themelorë të pjesëmarrjes në sport në nivelin më të lartë. Qëllimi i këtij studimi ishte të analizojë disa ndryshore garuese që mund të kufizojnë taktikat e një ngritësi të topit në akcion, në volejbollin për femra të nivelit të lartë, si dhe rezultatet e tyre. Gjashtë ndeshje të Kupës Botërore për femra 2006 analizuan duke kategorizimin e sistemit, duke përsëritur në metodologjinë vëzhguese, domethënë teknikën e analizës vijuese të vonesës. Tempo penal-sulmi paraqitet si një variabël kryesor në taktikat e ngritësive në akcion. Si një sulm i shpejtë si pasojë ka mbrojtjen më të dobët të bllokut. Studimi arriti në përfundimin se pranimet në zonat 4 dhe 1 prodhuan sulme të ngadalta, të cilat rezultuan në blloqe të dyfishtë dhe të trefishtë të përbashkëta të kundërshtarëve. Efektiviteti i sulmit duket se është i pavarur nga akcioni i ngritësive, megjithëse kjo e fundit ka ndikuar shumë në llojin e bllokut të kundërshtarit. Kështu, analiza e ndeshjes hap mundësinë e analizimit nga aspekte të reja që përfshijnë veprim taktik mbi volejbollistët kulmor.

Në këtë drejtim janë bazuar edhe hulumtimet e gjertanishme, por shumë të pakta janë ato të cilat kanë pasur qëllim të hulumtojnë rëndësin dhe ndikimin e vetëm një elementi teknik në suksesin e arritur në lojën e volejbollit.

Inkinen me bo. (2013) duke përdorur analizën notanale, analizuan efikasitetin e elementeve tekniko-taktike në garat në garat e volejbollit të femrave për junior dhe senior. Qëllimi i tyre ishte të krahasojnë performancën në këto dy nivele të moshës së garave dhe të sqarojnë dallimet midis ekipeve fituese dhe të mundura në setet e volejbollit. Rezultatet treguan se ekzistojnë vetëm dallime të vogla në mes junioreve dhe senioreve. Efekasiteti i i gjuajtjeve është treguar të jetë parashikuesi më i rëndësishëm i suksesit edhe te junioret edhe te seniorete.

Peña me bp. (2013) një mostër prej 125 ndeshje të luajtura gjatë sezonit 2010/2011 në kampionatin e volejbollit të ligës së parë spanjolle, hulumtuan se cilat aftësi dhe faktorë ndikojnë në rezultatin e ndeshjes së sezonit të rregullt të volejbollit dhe rëndësinë e tyre për arritjen e rezultateve pozitive në lojë. Ndeshjet janë luajtur nga ana e 12 ekipeve të përbërë nga 148 lojtarëve nga 17 vende të ndryshme nga tetori 2010 deri në mars 2011. Variablat e analizuara ishin rezultatet e ndeshjes, 43 kategoritë e ekipeve, faktorët terreni vendas dhe mysafir, pika e fituar nga kundërsulmi, numri i gabimeve në shërbim, numri i as- shërbimeve, numri i gabimeve në pranim, përqindja e pritjeve positive të përsosura, efikasiteti i pritjes, numri i gabimeve në sulm, numri i sulmeve të bllokuara, pikët të fituara nga sulmi, përqindja e pikëve në sulm, efektiviteti i sulmit dhe numri i bllokimeve të dy ekipeve në ndeshje. Rezultatet treguan se variablat e kategorive të ekipeve, pikët e fituara në kundërsulm, numri i gabimeve në pranim dhe numri i pikëve të shënuara nga blloku ishin faktorë të rëndësishëm për fitoren ose humbjen. Raporti i shanseve tregon shanset për të fituar në lojën e volejbollit 6,7 herë më të madhe për ekipet më të ranguara dhe se çdo pikë shtesë në kompleksin 2 rrit mundësinë për të fituar 1.5 herë. Çdo gabim në pranim dhe bllokimin e topit zvogëlojë mundësinë për të fituar 0.6 ose 0.7 herë.

Silva me bp. (2013) kanë studiuar se çfarë ndodh kur ngritësi në fushën e sulmit (zona 4, 3 dhe 2) dhe në identifikimin aftësive që ndikojnë të cilat ndikojnë më tepër fitoren apo humbjen në lojë. Njëzet e katër ndeshje ($n = 24$) të luajtur gjatë Kampionatit Botëror për senior për meshkuj në Itali në vitin 2010, janë analizuar me ndihmën e paketës programore Data Volley. Është vërtetuar se pike shërbimi, gabimi në shërbim, ngritja ideale, gabimi në ngritje, gabim në sulm dhe mbrojtja ideale e fushës janë variabla thelbësore që përcaktojnë

rezultatit përfundimtar të lojës (fitore / humbje) kur ngritësi është në fushën e sulmit (zona 4, 3 dhe 2). Ekipet me më pak kualitet sulmi, shërbimi dhe organizim të dobët të lojës do të jetë e vështirë për të fituar, sepse këto aftësi janë të rëndësishme për ndërtimin e sulmit dhe fitores. Silva et al. (2013) hulumtuan variablat vendimtare sipas pozitës të ngritësit në zonën mbrojtëse (Zona 1, 06:05) në 49 ndeshje të luajtura në finalen e garave të rëndësishme ndërkombëtare të luajtura në mes të 2010 dhe 2012 (në Kupën e Botës, liga Evropiane, Kampionati European, Liga botërore, Lojërat Olimpike). Të dhënat u grumbulluan duke përdorur paketën e programeve Data Volley. Rezultatet treguan se gabimet në pranim, pika nga kundërsulmi, gabimi në ngritje, dhe pika nga sulmi janë variabla të rëndësishme që mund të identifikojnë rezultatit përfundimtar (dmth, fitore apo humbje) në ndeshjen kur ngritësi ishte në rreshtin e dytë. Në fakt, ky hulumtim shpjegon pse ekipet e volejbollit po fitojnë; poentimi nga sulmi dhe kundërsulmi shpesh parashikon një rezultat fitues. Ky hulumtim bën një kontribut të rëndësishëm në trajnimin e volejbollistëve dhe gara.

Campos me bp. (2014) kanë hulumtuar përparësinë e lojës si vendase të ligat e volejbollit elitë për femra dhe ndikimin e treguesve të performancës në rezultatit e ndeshjes sipas numrit të seteve. Mostra përbëhet nga 240 ndeshje (132 ndeshje të Ligës së Volejbollit Brazilian) dhe 108 ndeshje të Ligës Italiane të Volejbollit në sezonin 2011-2012. Është vlerësuar raporti i treguesve të suksesit (duke përfshirë shërbimin, sulmin, bllokimin dhe gabimet e kundërshtarit) dhe rezultatit e ndeshjes (fitore ose humbje). Rezultatet treguan ekzistimin e efektit të përparsisë të terrenit vendor të ligat e volejbollit për femra, me frekuencion më të shpeshtë të fitoreve si vendas për ligën braziliane dhe italiane (58 dhe 56%). Rezultatet treguan ekzistimin e efektit të avantazhit më tepër ishte kryesisht i lidhur me fitoren dhe ishte një tregues teknik që shpjegoi pjesën më të madhe të rezultateve në ndeshje.

Costa me bp. (2014) analizuan korrelacionin e cilësisë së pranimit të shërbimit, kohën e sulmit dhe llojin e bllokut lloji i bllokut me efikasitet dhe llojin e sulmit. Mostra e subjekteve të anketuar përfaqësonte 18 ndeshje të Superligës braziliane për volejbollistë në sezonin e garave 2011/2012. Një total u analizuan 2348 akcione në sulm në sulmin. Rezultatet treguan se gabimet në sulm janë të lidhura me bllokun e dyfishtë, ndërsa sulmet pas së cilës topi mbeti në lojë ishin të lidhura me blloqet e dyfishta dhe trefishe. Kjo tregon mbi respektin që lojtarët kanë kur gjuajn përball bllokut të trefishtë sepse zgjedhin sulme më pak të rrezikshme me qëllim që topi të mbetet në lojë. Pranimet ideale të shërbimeve që i lejojnë teknikeve të

ndërmarrin akcione të ndryshme në sulm dhe sulme të forta janë të lidhura me përfundimin e akcioneve pas gjuajtjes. Ritmi i sulmit ishte negativisht i lidhur me precizitetin e ngritjes nga e cila theksohet se skuadrat e ekipet braziliane të femrave ende kanë hapësirë për përsosjen e lojës së shpejtë në sulmit, ose që nganjëherë në situata ku kjo nuk është e justifikuar taktikisht forcojn ndeshjet me ritme të shpejta.

Lin (2014) analizoi mundësinë e aplikimit të teorisë së lojërave sportive në krijimin e një strategjie për një konkurrent të veçantë në ndeshje. Kjo strategji që krijohet para garës, gjatë lojës, përshtatet me rrethanat e reja sipas nevojës. Autorja arrin në përfundimin se volejbollistet dhe volejbollistët mund të ndjekin udhëzimet strategjike dhe të bëjnë rregullimet e nevojshme gjatë lojës. Rezultatet e fituara tregojnë se teoria e lojërave sportive mund t'u ofrojë trajnerëve dhe lojtarëve informacione të dobishme për krijimin dhe zbatimin e strategjisë gjatë lojës.

Marcelino me bp. (2014) analizuan gjasat e parashikimit të rezultatit të një sulmi në volejbollin elitare tek meshkujt. Në 19 ndeshje të Kampionatit Botëror të Volejbollit për meshkujt të vitit 2006, morën parasysh dimensionet lidhur me hapësirën, detyrat, lojtarët dhe efektivitetin e akcioneve të përzgjedhura (pranimi, ngritja dhe sulmi). Është aplikuar logjika multinomiale e regresionit me shkallë të rëndësisë .05. Rezultatet treguan se sinjalet më të rëndësishme për parashikimin e një sulmuesi të caktuar lidhen me aspektet e ngritjes së topit (zona e ngritjes, pozita e ngritjes, lloji i ngritjes), pozicionet e lojtarit në mes dhe lojtarët pranues. Në tërësi, zgjedhja e sulmuesve është shumë e parashikueshme dhe mund të pritët nëpërmjet analizës së shenjave vizuale që i paraprijnë sulmit. Njohja e këtyre modeleve do të rrisë shkallën e suksesit për ekipet mbrojtëse, ndërsa ekipet sulmuese duhet të përpiqen të krijojnë strategji që do të përdorin mënyra të ndryshme të lojës në secilin grup, duke zvogëluar aftësinë e kundërshtarit për të parashikuar veprimet e tyre.

Laporta me bp. (2015) në një mostër prej 14 ndeshjeve të Kupës së Botës për femra që luajtën në vitin 2013 u analizuan lëvizjet e volejbollit në mbrojtjet nga sulmi. Ata veçuan 277 aksione në këtë kompleks (K4), që është 4.1% nga numri i përgjithshëm i aksioneve. Nga këto 277 aksione, 128 u zhvilluan pas sulmit, pra, pas kompleksit 1 (K1) dhe 149 pas kundërsulmit, pra, pas kompleksit 2 (K2). Autorët kanë vërejtur gati 29 sisteme të ndryshme mbrojtëse. Ato mund të ndahen në bazë të kriterit të numrit të rreshtave (linjave) që kanë formuar lojtarët në distanca të ndryshme nga rrjeta në sistemet e mbrojtjes në një, dy, tre dhe katër rreshta. Më shumë se 60% e aksioneve të mbrojtjes kanë kryer në 2 rreshta, dhe një tjetër 1/3 në rreshtin e 3-

të. Sistemet e mbrojtjes në një dhe katër rreshta së bashku ndodhin në rreth 6% të aksioneve. Vetëm dy formacione (2: 2 dhe 2: 3) janë regjistruar në më shumë se 10% të aksioneve. Një numër i barabartë i aksioneve pas mbrojtjes së suksesshme (23%) përfunduan pas gabimit gabimit apo pikëve të shënuara në një kundërsulmi, dhe në aksionet e mbetura të lojës vazhdon pas realizimit të kundër-sulmit. Autorët theksojnë nivelin e lartë të lidhjes midis tempos së sulmit dhe strukturës së mbrojtjes së sulmeve në K1 dhe K2. Me këtë, sulmet me ritmin e parë jo vetëm që vështërsojnë formimin e një bllok kompakt nga ana e bllokueseve rivale, por edhe bashklojtareve vështërsojnë formimin e mbrojtjes efektive të sulmit. Në mënyrë indirekte, kjo lidhje ndikon gjithashtu në cilësinë e saktësisë (precizitetit) të pranimit dhe zonës së sulmit me strukturën e mbrojtjes së sulmit. Autorët arrijnë në përfundimin se gjatë përsosjes të këtij kompleksi të lojës duhet të mësojnë parimet e mbrojtjes, e jo të përmbahemi strikt formacioneve të caktuara (p.sh. 3: 2 ose 2: 3). Për shembull, një parim (këshilla apo udhëzime lojtarëve) me një mundësi shumë të gjerë aplikimi do të jetë: "Nëse jeni afër mbroje fushën në afërsi të tij, por nëse ju jeni larg nga gjuajtësi mbrojer pjesën e thellë të fushës (pas linjës së sulmit)." Ky lloj i të mësuarit mundëson fleksibilitetin e nevojshëm të lojtarit, pra, përshtatshmërinë e tyre ndaj situatave të ndryshme në lojë.

Palao me bp. (2015) krahasuan dallimet në frekuencën dhe cilësinë e performancës së disa elementeve teknike-taktike midis ekipeve hituese dhe humbëse në volejboll. U analizuan aksionet e 91 lojtarëve në 13,939 pikë gjatë 84 ndeshjeve (179 grupe) të luajtur gjatë Turneut Botëror të Volejbollit 2008. Realizimi i disa aksioneve u analizuan në lidhje me rezultatin e tyre, si dhe zgjedhjen e opsioneve që ekipi kundërshtar kishte në dispozicion pas zbatimit të tyre. Analiza diskriminuese zbuloi se ekipet fituese kanë performancë dukshëm më të mirë në kryerjen e shërbimit, panimit të shërbimit, ngritjes për gjuajtje dhe gjuajtjeve në sulm.

Kountouris, P. Me bp. (2015) krahasuan ndryshimet midis meshkujve dhe femrave në efektivitetin e aktiviteteve tekniko-taktike të volejbollit. Ai përcjelli pesë elemente: shërbimin, pranimin, sulmin, bllokun dhe mbrojtjen në ekipet e nivelit të lartë kombëtar në katër garat e fundit Olimpike. Rezultatet treguan se volejboli për meshkuj dhe femra është veçanërisht i ndryshëm në dy gjëra. Meshkujt kanë një përqindje më të lartë të gabimeve në shërbim sesa femrat, kurse te meshkujt është efikasiteti dhe realizimi i sulmeve.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Vazhdimisht në lojën e volejbollit elementet teknike dhe taktike të sulmit kanë pësuar një evolucion të jashtëzakonshëm. Ky evolucion ka ndodhur në sajë të përsosjes së teknikave të reja realizuese dhe metodikave përkatëse, në kushtet e një sigurie të plotë për volejbollistët dhe janë reflektuar me shpejtësi dhe efikasitet të ekzekutimit duke iu falënderuar organizimit të mirë të proceseve stërvitore.

Metodat e reja karakterizohen nga një shpejtësi e konsiderueshme të ekzekutimit dhe gjindshmërisë, duke shfrytëzuar në maksimum dhe me saktësi të madhe parimet biomekanike që rregullojnë të gjitha format e lëvizjes si dhe gjindshmërisë në fushë e sidomos në fazën e sulmit.

Qëllimi parësor i punimit është që në kuadër të elementeve teknike të ekzekutuara të cilat ndikojnë në fitimin e pikëve, sa është kontributi i pikëve të fituara nga shërbimet e ekzekutuara gjatë lojës të finalistëve të Kupës së Kosovës 2018 në volejboll, të volejbollistëve të KV. “Kastriotit” nga Ferizaji dhe KV. “Drita” nga Gjilani; dhe finalistëve të Kupës së Kosovës 2019 në volejboll të KV “M-Technologie Prishtina Voley“ dhe KV “Skenderaj” nga Skenderaji.

Qëllimit sekondar i këtij punimi është se nga shërbimet e aplikuar të vërtetohet se cila ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes dy ekipeve fituese të Kupës së Kosovës, KV “Skenderaj” nga Skenderajiv 2019 dhe KV. “Kastriotit” nga Ferizaji 2018.

Qëllimit terciar të këtij punimi është se nga shërbimet e aplikuar të vërtetohet se cila teknik nga katër llojet e shërbimeve është më e efektive:

- Shërbimi tenis
- Shërbimi valëvitës
- Shërbimi me kërcim

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrihen këto hipoteza:

H₀₁ – Shumica e shërbimeve si element teknik në fazën e sulmit në lojën e volejbollit ekzekutohen nga Shërbimi valëvitës.

H₀₂ – Shumica e pikëve të fituara nga shërbimet në Finalet e Kupes së Kosovës do të fitohen nga Shërbimi me kërcim.

5. METODOLOGJIA E PUNËS

5.1 MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila do të meret mostra për këtë punim është definuar si popullatë e volejbollisteve seniore, lojtare të dy klubeve, finalistëve të Kupës së Kosovës 2019 në volejball, të KV “M-Technologie Prishtina Voley“ dhe KV ”Skenderaj” nga Skenderaji dhe të dy klubeve finalistëve të Kupës së Kosovës 2018 në volejball, të KV “Drita“ nga Gjilani dhe KV ”Kastrioti” nga Ferizaji.

Në këtë hulumtim do të përfshihen gjithsej 20 volejbolliste seniore të dy klubeve të Supelīgës së Kosovës, finalistëve të Kupës së Kosovës 2018 edhe atë 10 volejbolliste ose lojtare KV “M-Technologie Prishtina Voley“ nga Prishtina (volejbolistet që kanë shënuar ose humbur pikë) dhe 10 volejbolliste ose lojtare të KV”Skenderaj” nga Skenderaji, (volejbolistet që kanë shënuar ose humbur pikë) si dhe 10 volejbolliste ose lojtare KV “Drita“ nga Gjilani (volejbolistet që kanë shënuar ose humbur pikë) dhe 10 volejbolliste ose lojtare të KV”Kastrioti” nga Ferizaji.

5.2 NDRYSHORET E APLIKUARA

Për qëllimet e këtij hulumtimi, si ndryshore është marr numri dhe efikasiteti i shërbimeve gjatë lojës.

Shërbimi është goditja fillestare me të cilin fillon loja apo çdo aksion, ekzekutohet në fillim të setit dhe pas çdo pike te fituar apo gabimi të bërë nga ana e skuadrës kundërshtare. Lojtar duhet të goditë topin në mënyrë që topi të kalon rrjetën dhe të godet vendin brenda terrenit të skuadrës kundërshtare. Ka dy lloje të shërbimit – nga lartë dhe poshtë, por sot në volejballin bashkëkohor askush nuk ekzekuton shërbimin nga poshtë. Por, për realizimin e qëllimit të këtij punimi do të aplikohen katër lloje të shërbimeve:

- Shërbimi tenis
- Shërbimi valëvitës
- Shërbimi me kërcim

5.2 TEKNIKA E EKZEKUTIMIT TË SHËRBIMEVE

5.2.1 Shërbimi - Teknika e ekzekutimit

Loja në volejboll filon me shërbim, andaj ate mund t'a quajm gjuajtje e parë gjegjësisht në volejbollin modern si sulm i parë i skuadrës me të cilin tentojmë që të marrim pikë direkte ose t'ia vështësojmë pranimin e shërbimit ekipit kundërshtar, me qëllim që ai mos të organizoi një sulm të mirëfilltë. Gjatë një seti ma së shumti mund të fitohen deri në 5 pikë drejtpërsëdrejti nga shërbimi, pika e fituar direkt nga shërbimi në mënyrë të popullarizuar quhet "AS", andaj këtij elementi teknik të volejbollit është mirë që t'i kushtohet një rëndësi e veçantë gjatë procesit të mësimit dhe aplikimit të tij gjatë ndeshjeve të volejbollit.

Para ekzekutimit të shërbimit lojtari nuk duhet të përplasi topin mbi dysHEME pasi më mirë është që gjatë 8sek. që i ka në dispozicion për të ekzekutuar ate, ai duhet të mendoj ku ta adresoj topin. Pasi vendos një gjë të tillë, truri merr informacionin e duhur për këtë qëllim dhe ua dërgon muskujve me qëllim që ato të përgatiten për një veprim të tillë. Të gjithë volejbollistët duhet që shërbimin gjatë lojës ta ekzekutojnë nga e njejta distancë, nga vendi më i afërt ku ata luajnë në mbrojtje dhe në mënyrë të njejtë prapa vijës fundore (sikurse e ushtron ate në stërvitje), dhe kurr nuk duhet të nguten (pos rasteve që e kërkojnë një gjë të tillë), në shërbim duhet shkuar ngadal duke zënë pozicionin më të volitshëm për të marrë "nishan" dhe pastaj duhet goditur topin në mënyrën e ushtruar. Nëse hudhja e topit gabohet atëherë më mirë është që topi të goditet lehtë sa për ta kaluar ate në anën tjetër të rrjetës, pasi rregullat nuk lejojnë përsëritje të shërbimit.

Kur një skuadër krijon një epërsi të dukshme pikësh atëherë shërbimin duhet ekzekutuar edhe më me forcë, me qëllim që të shënohet pikë direkte me te, por ka disa momente kur nuk duhet gabuar ate, këto momente janë: në fillim të lojës, pas një pushimi, kur paraprakisht është humbur shërbimi nga bashkëlojtari i tij, kur kundërshtari ka fituar në seri disa pikë, kur lojtari sapo ka hyrë në lojë etj.

Për qëllimet e këtij hulumtimi, si ndryshore është marr numri dhe efikasiteti i shërbimeve gjatë lojës.


Shërbimi është goditja fillestare me të cilin fillon loja apo çdo aksion, ekzekutohet në fillim të setit dhe pas çdo pike te fituar apo gabimi të bërë nga ana e skuadrës kundërshtare. Lojtar duhet të goditë topin në mënyrë që topi të kalon rrjetën dhe të godet vendin brenda terrenit të skuadrës kundërshtare. Ka dy lloje të shërbimit – nga lartë dhe poshtë, por sot në

volejbollin bashkëkohor askush nuk ekzekuton shërbimin nga poshtë. Por, sot në volejbollin kulmor hasim më shpesh katër lloje të shërbimeve:

- Shërbimi tenis
- Shërbimi valëvitës
- Shërbimi me kërcim

Shërbimi më i popullarizuar është shërbimi me kërcim (shërbim gjuajtje) që mund të jetë i vështirë për praninë në qoftë se shërbimi ka shpejtësi të lartë dhe rotacion.

Skema 1. Llojet e shërbimeve



5.2.2 Shërbimi tenis

Ky lloj i shërbimit mund që të mësohet shumë lehtë, mënyra e goditjes është shumë e ngjajshme me gjuajtjen në volejboll. Gjatë mësimin të këtij lloji të shërbimit duhet patur kujdes që të ruajm nga lëndimi nyen e shpatullës, pasi e gjithë forca për gjuajtje vjen nga ky artikulation. Shërbimi nga lartë është më i popullarizuari ndër volejbollistë dhe mund që të na shërbej deridiku si uvertyrë për mësimin e gjuajtjes. Gjatë ekzekutimit të këtij lloji të shërbimit marrin pjesë shumë grupe muskujsh (ato të barkut dhe shpinës) dhe kemi një amplitude më të madhe të lëvizjes. Rregulla themelore e ekzekutimit të shërbimit nga lartë. Duhet të qëndrohet pas vijës fundore të fushës së volejbollit, përball rrjetës, me trup jo të shtangur, këmba e kundërta me dorën goditëse vendoset para, këmba prapa vendoset në një kënd prej 45 gradësh, dhe që të dyja këmbët lehtë të lakuara në gjunjë. Topi hedhet lartë dhe 50cm para vetëvehtes, ashtu që ai duhet të jetë në mes të këmbës që kemi para dhe shpatullës së dorës goditëse e cila është bashkë me brylin në lartësi të shpatullave ose pak më lartë gjatë tërë procesit të ekzekutimit të shërbimit.

Foto 1. Shërbimi tenis



Më pastaj trupi lëvizën duke zhvendos peshën tek këmba para ose bëhet një hap përpara duke e goditur topin. Në momentin e goditjes dora është e shtrënguar dhe topi goditet në mes, në pjesën e prapme të tij me pëllëmbë me një goditje të plotë, krahu e përcjellë lëvizjen e topit në drejtim të caktuar dhe lëvizja e dorës mbaron drejt përpara ose paralel me topin.

Në këtë lloj të shërbimit krahu rrotullohet me një lëvizje të pandërprerë e cila është shumë e ngjajshme me gjuajtjen në volejball. Topi duhet goditur në mes me rrënjën e shuplakës ose me vetë shuplakën, e cila në momentin e kontaktit me topin është e shtangur dhe rahu lehtë i lakuar në nyjen e brryllit. Ky lloj i shërbimit karakterizohet me lëvizje të natyrshme të krahut, andaj është i lehtë për tu mësuar.

Në fillim duhet që ushtruesit të vendosin zonën, lojtarin ose vendin ku duhet të adresojnë topin e shërbyer dhe më pastaj caktojnë sipërfaqen e topit e cila duhet të vijë në kontakt me shuplakën.

Kur ushtruesit mësojnë këtë lloj të shërbimit në fillim të stërvitjes së tij duhet insistuar në përsosmërinë e precizitetit dhe pasi të arrijnë ushtruesit që të kryejnë këtë veprim pa gabim, atëherë duhet insistuar që ushtruesit topin ta gadasin edhe fuqishëm me qëllim që të mundën të marrim pikë direkte nga ekzekutimi i këtij lloji të shërbimit.

5.2.3 Shërbimi valëvitës

Ky lloj i shërbimit më së tepërmi është përdorur në Europë, Amerikën Veriore dhe atë Jugore. Që të ekzekutohet drejt ky lloj i shërbimit nevojitet një forcë më e madhe e muskujve të shpatullës, por duhet patur kujdes që mos të vi deri tek lëndimi i tyre. Ky shërbim mund që të mësohet shumë lehtë pasi faza e parë e lëvizjes është e ngjajshme me atë të gjuajtjes.

Që të ekzekutojmë dhe mësojmë saktë këtë lloj të shërbimit ushtruesit duhet të vendosen në një pozicion të kthyer nga fusha kundërshtare, me shputa të hapura sa gjerësia e shpatullave ku e majta është e kthyer në drejtim të rrjetës, kurse e djathta vendoset në një kënd prej 45 gradësh nga ajo, me këmbë lehtë të lakuara në artikulacionet e gjunjëve. Para së të ekzekutoj ushtruesi këtë lloj të shërbimit, ai duhet të piketojë vendin ku do ta adresojë atë.

Pasi të goditet topi shkurt dhe sakt, dora duhet ndalur menjëherë d.m.th. në ekzekutimin e shërbimit valëvitës nuk kemi vazhdim të lëvizjes së dorës dhe as të gishtërinjëve, por nëse bëhet një gjë e tillë atëherë kemi krye shërbimin nga lart.

Dora që bën hedhjen e topit duhet të jetë plotësisht e shtrirë dhe lëvizja e saj është e pandërprer, topi hedhet në 1m lartësi në momentin e lartësisë së shpatullave.

Foto 2. Shërbimi valëvitës



Kryesisht ndjekja e rrugës metodike për mësimin e ekzekutimit të këtij lloji të shërbimit është e njëjtë sikurse edhe ndjekja e rrugës metodike për mësimin e kryerjes së shërbimit nga lart, por këtu duhet të kemi kujdes të posaçëm në momentin e ndaljes së dorës që ajo të bëhet menjëherë pas momentit të goditjes së topit.

I përket grupit të shërbimeve me ekzekutim ballor pa kërcim dhe u shfaq pas shërbimit pa kërcim dhe pa rotacionin të topit (shërbim japonez). Për shkak të ekzekutimit të lehtë dhe përvetësimit të lehtë të teknikes është bërë e përhapur. Në vitet e fundit, është lënë pas shërbimeve që ekzekutohen nga kërcimi sepse kanë një kohë shumë më të shkurtër të fluturimit të topit. Për lojtarët kulmor zakonisht paraqet një alternativë, ndërsa lojtarët me nivel më të ulët përdorin kryesisht si një shërbim bazë.

